

Konkurs ndërkombëtar për projekte 'Rinia dhe Puna në Bosnje e Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi'

'Swiss Labour Assistance' dhe 'Syri i Vizionit' kanë kënaqësinë e organizimit të një konkursi ndërkombëtar të projekteve për rininë dhe punën. Të gjitha organizatat rinore të cilat janë të etura për të kontribuar në paqen shoqërore në vendet e tyre ose të rajonit dhe kanë ndonjë ide inkurajuese për të promovuar të drejtat në punë dhe shqetësimet e sindikatave janë të ftuara për të hyrë në garë me nga një projekt të vogël.

Pranueshmëria, vlerësimi dhe shpërblimi:

Konkursi është i hapur për të gjithë sektorët e rinisë në sindikata dhe të gjitha organizatat e të rinjve tjera të regjistruara ligjërisht në Serbi, Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë. Swiss Labour Assistance dhe Syri i Vizionit do të përzgjedhin nga secili shtet maksimalisht nga pesë ide të projekteve (si fushata, ngjarje, trajnime, studime, etj.) të cilat prekin në një apo më shumë temat të renditura më poshtë. Projekt propozimet përfundimtare do të paraqiten në një konferencë ndërkombëtare ku organizatat rinore pjesëmarrëse do të vlerësojnë dhe shpërblejnë projektin më të mirë prej secilit shtet. Fituesit do të shpërblehen me nga një grant deri në 5.000 euro për të zbatuar projektin. Shpenzimet për rroga dhe infrastrukturë nuk do të mbështeten.

Temat:

Tregu i punës, promovimi i punësimit, punësimi i të rinjve, nëpunësimi dhe udhëheqja profesionale, sindikatat dhe dialogu social, puna e përshtatshme, siguria dhe shëndeti në punë, kushtet e punës, barazia dhe diskriminimi (të zhvendosurit, pakicat, gratë, njerëzit me nevoja të veçanta), siguria sociale, ekonomia joformale dhe migrimi për punë.

Aplikimi:

Nga të gjitha organizatat kërkohet të dorëzojnë nga një propozim të shkurtër në gjuhën angleze. Ai duhet të përshkruaj

1. Qëllimet e projektit,

2. Idenë e projektit, aktivitetet,

3. Përshkrimin e buxhetit dhe

4. Organizatën rinore (gjërat themelore shkurtimisht: themelimin, aktivitetet më të rëndësishme, vendndodhjen gjeografike, fondet, kontaktin).

Propozimi i shkurtër nuk duhet të jetë më i gjatë sesa një faqe A4 dhe duhet të dërgohet më së voni deri më 13 shtator 2009 si dosje .PDF tek christoph.baumann@sah.ch dhe vizioni@gmail.com. Pranimi i propozimit do të konfirmohet. Aplikimet që nuk konfirmohen nga ana jonë, nuk do të merren parasysh (në këtë rast, ju lutem dërgoni atë përsëri).

Në momentin që propozimet e shkurtra do të përzgjidhen, organizatorët do të informojnë për procedurën e radhës për të përpiluar projekt propozimet përfundimtare dhe për detajet e konferencës.

Rregullat e garimit:

Organizatorët janë të zotuar për mirëbesim dhe neutralitet të plotë. Mu për këtë, ne nuk do t'i përgjigjemi asnjë kërkesë deri më 13 shtator 2009, e as nuk do t'ua kalojmë përshkrimet e projekteve të dorëzuara palëve të treta.